

08 shkurt 2012

Reagim

Lidhur me kërkesën e KEK për rritjen e çmimit të energjisë dhe rivitalizimin e bllokut A2 të Kosovës A

Organizatat e lartshënuara të shoqërisë civile kundërshtojnë iniciativën e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) për rritjen e çmimit të energjisë elektrike dhe rivitalizimin e bllokut A2 të TC Kosova A.

Kërkesa e KEK për rritjen e energjisë elektrike për 23% nga 1 prilli 2012 nuk pasqyron koston reale të prodhimit të energjisë elektrike. Dështimi në ofrimin e mbështetjes institucionale për luftimin e keqpërdorimit të energjisë elektrike janë dështime qeveritare dhe janë problemi real i Korproatës dhe njëherësh edhe zgjidhja e problemit të mbulimit të koston së prodhimit të energjisë elektrike. Mos evitimi i humbjeve komerciale dhe teknike, po tentohet t'i faturohen qytetarëve.

Për shumë vite KEK është subvencionuar nga Qeveria e Kosovës. Gjatë kësaj kohe, KEK nuk ka arritur të eliminoj defektet në furnizim dhe zvogëlim të humbjeve në rrjet. Sipas vetë informatave të dërguara nga KEK në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) del se më shumë energji humbet në rrjet se sa totali që prodhohet nga Kosova A. Rritjen e energjisë elektrike KEK e arsyeton me ndalesën e subvencioneve nga Qeveria e Kosovës. Sipas tyre, nevojiten 45 milionë euro shtesë, të cilat KEK si zgjidhje ka paraparë të jetë rritja e çmimit të energjisë për 23%. Humbjet teknike dhe komerciale të energjisë arrijnë në 37%, humbje të cilat kapin vlerën prej rreth 77 milion eurosh. Shumë e cila do t'i mjaftonte KEK për të mbuluar shpenzimet e importit dhe ato operacionale. Përveq kësaj, kërkesa për ngritje të tarifave është bërë edhe për të mbuluar shpenzimet e mëdha financiare që KEK dëshiron t'i bëjë në termocentralin "Kosova A", shpenzime këto të kosta kur dihet që ky TC duhet të mbyllet në vitin 2017 në përputhje me Traktatin e Athinës. Njëherësh, vlerësimi i disa aseteve përkatëse në këtë termocentral, shton më tej përqindjen e kërkesës për ngritje të tarifave të energjisë elektrike, asete këto të kohës sovietike dhe të cilat nuk mund të vlerësohen drejtë në një kohë të tillë.

Për shumë vite me radhë, arsyetimi i KEK për mungesë të energjisë elektrike ka qenë mos pagesa e faturave nga konsumatorët. Të dhënat më të fundit nga KEK tregojnë se pagesa e energjisë elektrike nga konsumatorët arrin deri në 92%. Përkundër rritjes së inkasimit, KEK nuk ka arritur që këto mjete t'i shfrytëzoj për eliminimin e defekteve në rrjet dhe gjenerim. Konsumatori sot paguan mjaft për të mbuluar koston e prodhimit të energjisë elektrike dhe paguhet mjaft nga të gjithë që të gjithë të kenë energji elektrike sot në vend. KEK-u nuk po arrin të furnizoj të gjithë konsumatorët dhe as të evitoj humbjet komerciale në rrjet, si pasojë edhe mungesës së mbështetje institucionale. Organizatat e lartshënuara të shoqërisë civile ftojnë Zyrën e Rregullatorit të Energjisë të refuzoi kërkesën e KEK-ut për ngritje të tarifave dhe të obligoj ata të furnizojnë të gjithë konsumatorët me energji dhe të zbresin humbjet komerciale në rrjet në nivelin e pranueshëm dhe i cili mjafton për të siguruar të hyra të mjaftueshme për mbulim të koston së prodhimit të energjisë elektrike.

Shqetësuese për ne është edhe kërkesa për rivitalizimin e blloqeve të Kosovës A. Një kërkesë e tillë bie ndesh me Strategjinë e Kosovës për Energji 2010-2018, Studimin e Komisionit Evropian për

**Instituti për Studime të Avancuara GAP, Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), Instituti për
Politika Zhvillimore (INDEP)**

Dekomisionim të Kosovës A, Programin e Qeverisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Traktatin e Energjisë. Çmimi që do të paguhej për rivitalizim të kësaj njësie është shumë i lartë për konsumatorin, shëndetin e tij dhe mjedisin për rreth. Një plan i tillë është ekonomikisht i paqëndrueshëm sipas Komisionit Evropian dhe prodhimi që kjo njësi do të siguronte, mund të arrihet me uljen e humbjeve në rrjet dhe me përmirësimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e këmbimit të energjisë elektrike, si dhe në investime më të shëndosha në energjinë hidrike (me dhjetëra kërkesa për energji hidrike dhe të erës presin tash më shumë se një vit për licence për prodhim të mbi 200MW dhe të njëjtat duhet të realizohen në vend të rivitalizimit të njësisë A2). Ne kërkojmë që TC "Kosova A" të mbyllet sa më parë dhe më së largu deri në vitin 2017 dhe assesi të investohet më tej në të.

8 shkurt 2012
Prishtinë